

TERMAT DHE KUSHTET E PËRDORIMIT

1. HYRJE

Termat dhe Kushtet e Përdorimit rregullojnë aksesin dhe përdorimin e platformës nga përdoruesit e saj. Përmes krijimit të një llogarie ose përdorimit të platformës, ju pranoni dhe bini dakord me këto kushte.

2. QËLLIMI I PLATFORMËS

Platforma e Konsultimit Publik është një sistem dixhital i krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë për të mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve, organizatave dhe palëve të interesuara në procesin e konsultimeve publike.

3. PËRDORUESIT E LEJUAR

Platforma mund të përdoret nga:

- Qytetarët e Republikës së Shqipërisë.
- Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), Organizatat Joqeveritare (OJQ) dhe palët e tjera të interesuara.
- Administrata e Kuvendit të Shqipërisë.

4. REGJISTRIMI DHE SIGURIA

- Përdoruesit duhet të krijojnë një llogari përmes formularit të regjistrimit.
- Përdoruesit janë të detyruar të ruajnë kredencialet e tyre dhe të mos i ndajnë me persona të tjerë.
- Administrata ka të drejtën të pezullojë ose të fshijë llogari që shkelin termat e platformës.

5. PËRDORIMI I PLATFORMËS

- Përdoruesit mund të postojnë komente dhe të marrin pjesë aktivisht në konsultime publike.

- Nuk lejohet postimi i përmbajtjeve të pavërtetuara, të pavend, fyese, diskriminuese apo me përmbajtje të paligjshme.
- Administrata rezervon të drejtën të moderuar, refuzojë ose të fshijë komente që bien ndesh me rregullat.

6. TË DHËNAT PERSONALE DHE SIGURIA

- Përdoruesit bien dakord që të dhënat e tyre personale të përdoren sipas Politikave të Privatësisë.
- Përdoruesit kanë të drejtën të kërkojnë fshirjen e llogarisë dhe të dhënave të tyre personale.

7. PËRGJEGJËSITË

- Platforma nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e publikuar nga përdoruesit.
- Administrata nuk garanton akses të pandërprerë në platformë për shkak të mundësive teknike dhe mirmbajtjes.

8. KONTAKT

Për pyetje:

- **Email:** konsultimi@parlament.al
- **Adresa:** Kuvendi i Shqipërisë, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë

Përditësimi i fundit: 22 Shkurt 2025